

VENDIM
Nr.805, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO LUSHNJA”
SUBJEKTIT FIZIK: Z.EDI HALILAJ

Në mbështetje të ligjit nr.8410,datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik Z.Edi Halilaj licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Lushnjës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)